

FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS  
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA  
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVA

---



**RREGULLORJA**  
**E**  
**LOJËS SË NDERSHME**  
**(FAIR PLAY)**

## Hyrje

### Në çka bazohet loja e ndershme (Fair Play)?

Në konkurrencë të ndershme, respekt, miqësi, shpirt sportiv, barazi dhe sport pa substanca stimulues (doping), respektimi i rregullave të shkruara dhe të pashkruara si integriteti, solidariteti, toleranca, kujdesi, përsosmëria dhe gëzimi, janë shtyllat kryesore që ndërtojnë lojën e ndershme që mund të përjetohen dhe mësohen brenda dhe jashtë fushës së futbollit.

### Qëllimi dhe detyrat:

1. Futja e principit të Fair Play-it (*tani e tutje i referohemi si; lojës së ndershme*), në aktet normative të Federatës së Futbollit të Kosovës ka për qëllim që në mënyrë efektive të rrisë qëndrimin e sjelljeve morale dhe etike në lojën e futbollit, në respektim të rregullave të lojës, propozicioneve të garave, kundërshtarit, kryesive të klubeve, gjyqtarëve, simpatizuesve dhe përfaqësuesve të mediave në garat vendore duke krijuar një atmosferë sportive të mbështetur në respektin e ndërsjellët.
2. Promovimi dhe afirmimi i lojës së ndershme, duhet të jetë detyrë permanente e të gjithë mekanizmave të Federatës së Futbollit të Kosovës dhe gjithsecilit, pasi që në mënyrën më të mirë do të popullarizohet fryma dhe sjelljet sportive e të gjithë aktorëve në lojën e futbollit. Kjo formë e sjelljes në terrenet futbollistike ka për qëllim që përmes aplikimit të masave juridike dhe të tjera të ndikojë në zvogëlimin e dhunës në stadione.

### Vlerësimi i lojës së ndershme:

1. Federata e Futbollit e Kosovës me qëllim të promovimit të lojës së ndershme, përpilon listën ranguese të klubeve në aplikimin e rregullave të lojës së ndershme, (në elitën e futbollit). Emërtimi zyrtar i listës është; **“FAIR PLAY – LISTA“** e cila mund të emërtohet edhe në emër të sponsoruesit të garave, apo sponsoruesit të vet lojës së ndershme.
2. Vlerësimi i sjelljeve të pjesëmarrësve në ndeshje kryhet përmes zyrtarit të ndeshjes – delegatit (person zyrtar i Federatës së Futbollit të Kosovës). Delegati plotëson formularin e lojës së ndershme, dhe sipas nevojës mund ti konsultojë edhe gjyqtarët e ndeshjes. Formulari i vlerësimit në bazë të poenave (numri i

- pikëve të dhëna – vlerësuara) nga ana e delegatit, dërgohet tek komisioni i garave, së bashku me raportin zyrtar të ndeshjes në afatin e caktuar kohor prej; 24 orëve.
3. Formulari i Fair Play-it, përpilohet nga ana e komisionit të garave pas çdo xhiroje të zhvilluar dhe e njëjta i prezantohet opinionit të gjerë sportiv, me së largu; 48 orë pas përfundimit të ndeshjeve nga xhiroja e zhvilluar.
  4. Vlerësimi i Fair Play-it, kryhet në bazë të; 6 (gjashtë) kriterëve përcaktues të cilët janë:
    - Kartonët e kuq dhe të verdhë
    - Loja pozitive
    - Respektimi i kundërshtarit
    - Respektimi i gjyqtarëve të ndeshjes
    - Sjellja dhe qëndrimi i zyrtarëve të klubeve
    - Sjellja dhe qëndrimi i spektatorëve (publikes)

Me rastin e vlerësimit – rëndësi të madhe duhet ti kushtohet aspektit të lojës pozitive, kështu që nota maksimale e këtij pozicioni nuk duhet të jetë e ndikuar në ato raste kur ekipet nuk kanë angazhim të lojës dhe qëndrim për një paraqitje pozitive (këtu mendohet kur ekipet nuk kanë angazhimin luftarak).

## **KRITERET PËR VLERËSIM**

### **a) Kriteret individuale**

#### **1. Kartoni i verdhë dhe i kuq:**

- Ekipi i cili në një ndeshje nuk ka marrë asnjë karton të verdhë dhe të kuq, vlerësohet me;10 pikë.

#### **Zbritje maksimumi prej; 10 pikëve:**

- kartoni i verdhë, penalizohet me minus; 1 (një) pikë.
- kartoni i kuq pas dy të verdhëve, penalizohet me minus; 2 (dy) pikë.
- kartoni i kuq drejtpërsëdrejti, penalizohet me minus; 3 (tri) pikë.
- kartoni i verdhë plus kartoni i kuq, penalizohen me minus; 4 (katër) pikë.

## **2. Loja pozitive**

Me këtë kriter (lojë pozitive) shpërblehet ekipi i cili është atraktiv për spektatorë. Maksimumi i pikëve në këtë lojë është; 10 pikë, kurse minimumi është; 1 pikë. Qëllimi i këtij rregulli është që të shpërblejë lojën pozitive që është tërheqëse për spektatorët. Në vlerësimin e lojës pozitive, aspektet e mëposhtme duhet të merrën në konsideratë.

**Me rastin e vlerësimit si elemente pozitive në këtë pozicion merrën në konsideratë këto aspekte:**

- përcaktimi i ekipit për lojë sulmuese (taktikë sulmuese më shumë se sa taktikë mbrojtëse).
- aplikimi i lojës së edukuar nga ekipi.
- përpjekjet e ekipit që të mos krijoje opstrukcione në lojë.
- përshpejtimi i lojës - loja e shpejtë.
- mos zhagitjet në ruajtje të rezultatit.
- ndjekja e vazhdueshme e objektivave, edhe në çoftë se së rezultati është në favor të ekipit që ka topin (p.sh, kualifikimin ose një hap barazimin) që tashmë është arritur.
- përpjekjet për shënime të pa rreshtuara edhe atëherë kur rezultati është i lartë.
- shënimi i golave.
- krijimi i shanseve për të shënuar etj...

**Si elemente negative në këtë pozicion vlerësohen – merren në konsideratë këto elemente:**

- ngadalësimi i lojës dhe aksioneve,
- humbja në kohë,
- taktikat e bazuara në ndërhyrje,
- simulimet e lojtarëve dhe,
- pjesë tjera të cilat cilësohen si negative.

### **1. Respekt për kundërshtarët:**

- Maksimumi..... 5 pikë.
- Minimumi..... 1 pikë.

Në rastin e aplikimit të këtij kriteri për bazë kemi sjelljet e lojtarëve në raport me rregullat e lojës, propozicionet dhe respektim të kundërshtarit (p.sh. ndihma lojtarit të lënduar kundërshtar e të ngjashme më këtë shembull) dhe krejt sikurse tek kriteret tjera bazohet në sjelljet pozitive (vlerësohet loja pozitive).

Sjellja e paqëllimshme, por pa ndonjë qëndrim pozitiv apo gjeste ndaj kundërshtarëve, duhet të vlerësohet me notën 4 (katërshe).

Te aplikimi i këtij kriteri duhet ikur vlerësimi të; kartonit të verdhë dhe të kuq, por delegati mund të këtë në konsideratë kundërvajtjet e rënda si dhe kundërvajtjet të cilat gjyqtari i ka vërejtur por nuk i ka penalizuar.

### **2. Respekti për gjyqtarët:**

- Maksimumi..... 5 pikë.
- Minimumi..... 1 pikë.

Në përputhje me rregullat e lojës nga lojtari kërkohet që të respektoi në mënyrën me të mirë të mundshme personalitetin e gjyqtarëve si dhe vendimet të cilat ata i sjellin gjatë lojës.

Sjelljet pozitive në raport me gjyqtarët duhet vlerësuar me notë të lartë, përfshirë këtu edhe rastin kur gjyqtari sjellë vendime të jo adekuate, ku lojtari të njëjtat i pranon pa ndonjë reagim negativë (pa manifestim të ndonjë proteste).

Sjellja normale, por pa ndonjë qëndrim të veçante pozitiv apo gjeste në lidhje me gjyqtarët e ndeshjes duhet vlerësuar me notë 4 (katërshe).

### **3. Sjellja e zyrtarëve të ekipit:**

- Maksimumi..... 5 pikë.
- Minimumi..... 1 pikë.

Nga zyrtarët e klubeve përfshirë edhe trajnerët kërkohet që të jenë në nivelin më të lartë në zhvillimin e reflektimit të frymës sportive, aplikimit të lojës tekniko – taktike, ngritjes

së moralit të ekipet të tyre, dhe kështu përmes shembujve të tillë të reflektojnë frymën e lojës së ndershme, e cila është në përputhje me parimet e lojës.

Aspektet pozitive dhe negative të sjelljes së zyrtarëve të ekipit duhet të vlerësohen; p.sh., nëse ata janë të qetë apo kanë provokuar lojtarë të zemëruar apo tifoz, se si ata pranojnë vendimet e gjyqtarit etj...

Bashkëpunimi me mediat duhet të konsiderohet si faktor në vlerësim.

Sjellja e pafajshme, por pa ndonjë qëndrim të veçantë pozitiv apo gjeste, duhet të vlerësohet me notën 4 (katërshe).

#### **4. Sjellja e publikut:**

- Maksimumi ..... 5 pikë.
- Minimumi..... 1 pikë.

Publiku konsiderohet të jetë një komponent i natyrshëm në një ndeshje të futbollit, andaj, mbështetja e tifozëve mund të kontribuojë në suksesin e ekipit të tyre.

Publiku nuk pritet të shohë ndeshjen në heshtje, inkurajimi i ekipeve në stadium mund të ketë një ndikim pozitiv në atmosferë, në përputhje me frymën e lojës së ndershme. Tutje, publiku pritet që të respektojë ekipin kundërshtar dhe gjyqtaret. Ata duhet të vlerësojnë lojën e ekipit kundërshtar, edhe nëse ata dalin si fitues. Ata nuk duhet në asnjë mënyrë të bëjnë presion për ta frikësuar ekipin kundërshtar, gjyqtaret apo mbështetësit e ekipit kundërshtar.

Një numër maksimal i pikëve që në këtë rastë është pesë (5), nuk duhet të jepet nëse të gjitha këto kërkesa nuk përmbushen.

Rregulli lartshënuar, është i zbatueshëm vetëm në qoftë se një numër i konsiderueshëm i tifozëve të ekipit në fjalë janë të pranishëm në stadium. Nëse numri i tifozëve të një ekipi është i pa përfillshëm, te kjo rregullore e vlerësimit nuk mundë të aplikohet për ekipin në fjalë.

#### **Vlerësimi i përgjithshëm**

Vlerësimi i përgjithshëm i ekipit fitohet në atë mënyrë që mbledhin pikët e dhëna në bazë të komponentës individuale, më pastaj ajo shumë e dhënë pjesëtohet me numrin

maksimal të pikëve, dhe numri i fituar nga ky pjesëtim shumëzohet me numrin 10 (dhjetë).

Numri maksimal i pikëve për një ekip në një ndeshje të zhvilluar është 40 pikë. Por, nëse ekipi ka numër të vogël të simpatizuesve të cilët cilësohen si “jo shembull“ raste të izoluar, atëherë ai ekip nuk vlerësohet me maksimum, por me 35 pikë (nga shkaku i këtij konstatimi të këtij grupi të spektatorëve), andaj maksimumi i pikëve për këtë ekip është 35 pikë.

### **Delegati i ndeshjes**

Delegati i ndeshjes në formularin e lojës së ndershme, përpos notës së zberthyer individuale, zberthen në formë të shkruar edhe arsyetimin e pikëve të vlerësuara sipas kriterëve të poentuara për ekipet garuese të ndeshjes.

Deklarimi me shkrim mund të përmbajë edhe përshkrimin e gjesteve individuale të lojës së ndershme, të ndonjërit prej akterëve të lojës të cilët hyjnë në konkurrencë të ndarjes së mirënjohjes së lojës së ndershme, për atë edicion garues.

### **Shpallja e Listës “ Loja e Ndershme“**

Ne fund të edicionit apo kampionatit garues shpallet fituesi i Listës së lojës së ndershëm, në kuadër të Federatës së Futbollit të Kosovës.

Fituesi në bazë të këtij plasmani duhet të shpallet ekipi me poentimin me të lartë të pikëve gjatë një kampionati (nga vlerësimet e kryera nga ana e delegatëve të ndeshjeve). Fituesit duhet ti takojë (kupa, pllaketa ose shpërblimi me të holla), njëheri ky klub fiton të drejtën për rangim edhe në listat e UEFA-së dhe FIFA-së, nëse klubet e Federatës së Futbollit të Kosovës kanë rangim të lartë në listat e lojës së ndershme, të këtyre dy asociacioneve të futbollit.

### **Caktimi i ditës së lojës së ndershme**

Para fillimit të garave në kampionat të rregullt zyrtarë, Federata e Futbollit të Kosovës duhet të caktojë terminin e ditës së lojës së ndershme, e cila sipas rregullave duhet të jetë në fillim të edicionit garues.

Dita e lojës së ndershme, mund të dakordohet me terminet e ditëve të lojës së ndershme, të organizuara nga ana e UEFA-së dhe FIFA-së.

## **Komisioni për Lojë të Ndershme (Fair Play)**

Komisioni për lojë të ndershme, është organ i Federatës së Futbollit të Kosovës i cili angazhohet në përcjellje të zhvillimit të garës në frymën e lojës së ndershme.

Komisioni përmes aktivitetit të saj promovon pa rreshtur lojën e ndershme. Komisioni bazuar në raportet e delegatëve shpallin edhe rastin e gjestit individual vjetor të lojës së ndershme, për të cilin duhet paraparë shpërblime të veçanta nga ana e Federatës së Futbollit të Kosovës.

**Prishtinë, 30 Korrik 2021**

**Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së,**

**Agim Ademi**